



## RISITË QË SJELL PROJEKTLIGJI “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT”

*Synimi themelor i projektligjit të ri është zhvillimi i sektorit të sigurimeve duke krijuar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit.*

Vijon në faqen 2

## ZHVILLOHEN MBLEDHJET E KOMITETIT EKZEKUTIV DHE TEKNIK TË IOPS-IT

*Mbrojtja financiare e konsumatorit duhet të jetë pjesë integrale e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës. Ajo duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë e rrethanave kombëtare të tregut global dhe zhvillimet rregullative në sektorin financiar.*

Vijon në faqen 4

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Tregu i sigurimeve për muajin janar 2012

*Buletini Statistikor për muajin janar 2012, përmban pasqyra të detajuara të ndarjes së Tregut të Sigurimeve, sipas llojit të sigurimit, produkteve të sigurimit, pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit në treg, etj.*

Vijon në faqen 5

## EDUKIMI I KONSUMATORIT

### Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private dhe roli i tyre në edukimin financiar

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)*

*(Materiali informativ është përpiluar nga një pyetësor i gjerë për çështjet e komunikimit dhe edukimit financiar nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private vullnetare. Në numrin e kaluar ju lexuat disa pika kryesore të këtij materiali informativ të hartuar nga bashkëpunimi i IOPS-it dhe OECD. Në vazhdimësi mund të lexoni disa tematika dhe shembuj nga vende të ndryshme).*

Vijon në faqen 6

## ZHVILLIME TË TJERA

*Në Bazel, Zvicër, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit të Koordinimit të Pensioneve, të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS).*

Vijon në faqen 10

## “Produktet e reja financiare: Sfidat e tyre rregullatore dhe përgjegjësia e IOSCO-s”.

*Kjo ishte tema kryesore e seminarit që zhvilluan Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në bashkëpunim me Sekretarinë e Përgjithshme të IOSCO-s dhe Komisionin e Letrave me Vlerë të Qipros.*

Vijon në faqen 11

## TË REJA NGA RAJONI

*Mali i Zi: MTPL ende dominon në treg, por konkurrenca rritet në sigurimin e jetës.*

Vijon në faqen 11

*Bosnje Hercegovinë: Sigurimi i jetës fiton përqindje të reja.*

Vijon në faqen 12

*Hungari: Tregu i sigurimeve ende i trazuar*

Vijon në faqen 12

# RISITË QË SJELL PROJEKTLIGJI “PËR VEPRIMTARINË E SIGURIMIT DHE TË RISIGURIMIT”

Synimi themelor i projektligjit të ri është zhvillimi i sektorit të sigurimeve duke krijuar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit.

Në dhjetor 2011 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfundoi hartimin e projektligjit “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”. Ky projektligj ishte rezultat i një pune disa vjeçare të Autoritetit. Synimi themelor i projektligjit të ri është zhvillimi i sektorit të sigurimeve duke krijuar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e konsumatorit.

## **Risite që sjell projektligji**

Duke u nisur nga zhvillimet e reja të tregut dhe nga nevoja e përshtatjes me direktivat e BE-së në fushën e sigurimeve, projektligji sjell mjaft risi ku mund të renditen:

### **1. Drejtimi i shoqërive të sigurimit.**

Projektligji fokusohet në strukturën e shoqërisë së sigurimit duke sjellë risi dhe vënë theksin tek drejtimi i shoqërisë së sigurimit më një nivel, si dhe kërkesat për qeverisje sa më të mirë të shoqërisë.

Duke e cilësuar shumë të rëndësishme drejtimin dhe vendimmarrjen tek shoqëritë e sigurimit, projektligji sjell një koncept të ri për kriteret që duhet të plotësojnë personat kyç në vendimmarrjen dhe drejtimin e shoqërisë. Drejtuesit e këtyre shoqërive parashikohet që duhet të jenë të aftë dhe të përshtatshëm për të marrë përsipër këto role, për parandalimin e konfliktit të interesit që këta persona mund të kenë gjatë

ushtrimit të roleve të tyre në shoqërinë e sigurimit, si dhe për parandalimin e transaksioneve me palë të lidhura. Synimi këtu ka qenë rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së personave, të cilët administrojnë dhe drejtojnë shoqërinë e sigurimit.

### **2. Mbikëqyrja me fokus riskun**

Mbikëqyrja e re me fokus riskun është një nga risitë më të rëndësishme që ka prezantuar ky projektligj. Koncepti themelor i kësaj metodologjie të re të mbikëqyrjes është të identifikojë zonat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe kur është e nevojshme, të punojë me menaxhimin e saj në mënyrë që ta ulë riskun në nivele të pranueshme. Synimi kryesor është që problemet financiare është më mirë të parandalohen përpara se të ndodhin, se sa të punohet për zgjidhjen e tyre pasi ato të kenë ndodhur. Duke u bazuar tek natyra e riskut, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare vendos prioritetet mbikëqyrëse dhe shkallën e ndërhyrjes në shoqëri, për ta risjellë riskun në nivele të pranueshme. Kjo do të bëjë që Autoriteti do të ketë një shpërndarje më eficiente të burimeve, duke u larguar nga metodologjia klasike me bazë rregullat.

### **3. Përforcimi i mëtejshëm i mbrojtjes së konsumatorit**

Projektligji ka në themel të tij sigurimin e mbrojtjes sa më efektive të konsumatorëve të cilëve u ofrohen produkte nga shoqëritë e sigurimit. Për këtë qëllim projektligji parashikon:

- informimin për të siguruarin nga shoqëria e sigurimit, përpara

nënshkrimit të kontratës në lidhje më subjektin e sigurimit, mbulimin, dhe çështje të tjera. Ky detyrim do të fillojë që para nënshkrimit të kontratës dhe do të vazhdojë edhe gjatë periudhës të vlefshmërisë të kontratës.

- rritjen e transparencës dhe informimit nga ana e shoqërive të sigurimit ndaj konsumatorit duke parashikuar dispozita specifike në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të cilat duhet t'i përmbajë kontrata e sigurimit.

- Direktiva e parë e Këshillit 73/239/EEC, e datës 24 korrik 1973, mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës.
- Direktiva e Këshillit 84/641/EEC, e 10 dhjetorit 1984, për asistencën turistike, e cila ndryshon Direktivën e parë (73/239/EEC) në koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me krijimin dhe kryerjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës.
- Direktiva e Këshillit 87/344/EEC, e datës 22 qershor 1987, mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin e shpenzimeve ligjore.
- Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/EEC, e datës 22 qershor 1988, mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e të drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës dhe që përcakton dispozitat për të lehtësuar ushtrimin efektiv të lirisë për të ofruar shërbime.
- Direktiva e Këshillit 92/49/EEC, e datës 18 qershor 1992 (Direktiva e tretë sigurimit të jo-jetës) mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sigurimin e drejtpërdrejtë, përveç sigurimit të jetës.
- Direktiva 2000/64/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 7 nëntorit 2000, për shkëmbimin e informacionit me vendet e treta.
- Direktiva 2002/13/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 marsit 2002, për sa i përket kërkesave të aftësisë paguese për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës.
- Direktiva 2002/92/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 9 dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime.
- Direktiva 98/78/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 27 tetor 1998, për mbikëqyrjen shtesë të shoqërive të sigurimit në një grup sigurimi.
- Direktiva 2005/68/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 16 nëntor 2005, për risigurimin.
- Direktiva 2001/17/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 19 mars 2001, mbi riorga-nizimin dhe likuidimin e shoqërive të sigurimit.
- Direktiva 87/343/ e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian për Sigurimin e Kreditit dhe Sigurimin e Garancive.

Projektligji është produkt i bashkëpunimit me Bankën Botërore dhe ekspertë të huaj të fushës së sigurimeve. Gjatë hartimit të tij janë marrë parasysh gjithashtu aktet ligjore në fushën e sigurimeve të disa vendeve si Kroacia, Maqedonia, Austria, Sllovenia, Bullgaria, Italia, Hungaria, etj. Projektligji është hartuar në përputhje me Direktivat Evropiane të fushës së sigurimeve.

Nëpërmjet Shoqatës së Siguruesë të Shqipërisë, shoqëritë e sigurimit

kanë sjelle komentet e tyre për këtë projektligj, të cilat po shqyrtohen nga AMF. Kjo ka qenë një fazë e parashikuar në procesin e miratimit të ligjit. Ndërkohë, Autoriteti është në kontakt të vazhdueshëm edhe me partnerët e huaj si Banka Botërore dhe Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC), si edhe me KPMG-në, shoqëri audituese, studio ligjore, etj, për të marrë edhe opinionet e tyre në lidhje me projektligjin.

Kërkesat e direktivave evropiane për lirinë e vendosjes së tarifave sipas tregut të lirë, kanë bërë që AMF të ketë një strategji të qartë veprimi për kalimin drejt një tregu eficient të sigurimit të detyrueshëm.

## ZHVILLOHEN MBLEDHJET E KOMITETIT EKZEKUTIV DHE TEKNIK TË IOPS-IT

Mbrojtja financiare e konsumatorit duhet të jetë pjesë integrale e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës dhe duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë e rrethanave kombëtare të tregut global dhe zhvillimet në sektorin financiar.

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, IOPS në bashkëpunim me Rregullatorin e Pensioneve të Anglisë, TRP zhvilluan gjatë periudhës 27 shkurt-1 mars, në Londër, Angli, aktivitetet e mëposhtme:

a) **Takimi i radhës së Komiteteve Ekzekutive dhe Teknike të IOPS-it.**

Në këtë takim diskutimet u përqendruan në problemet më të rëndësishme të mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve, duke përfshirë:

- o Një përmbledhje të zhvillimeve të mbledhjes së fundit të Komitetit Ekzekutiv, zhvillimet e fundit në tregun e pensioneve dhe financat;
- o Draftin e paraqitur nga sekretariati i IOPS-it, ku përshkruhen politikat e organizatës mbi publikimet dhe propozimi për një udhëzues, i cili ndihmon dhe siguron autorët në një qëndrueshmëri të botimeve të IOPS-it;
- o Prezantimin nga sekretariati i IOPS-it mbi *Principet në mbrojtjen financiare konsumatore në kuadrin e mësimeve të G20*. Besimi i konsumatorit në një treg që funksionon mirë për shërbimet financiare promovon stabilitetin financiar, rrit efikasitetin dhe inovacionin afat gjatë. Në prezantim u theksua, se kornizat tradicionale rregullatore dhe mbikëqyrëse të miratuara nga organet mbikëqyrëse, duhet të kontribuojnë në mbrojtjen e konsumatorëve, së bashku me stabilitetin financiar.

Mbrojtja financiare e konsumatorit duhet të jetë pjesë integrale e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës dhe

duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë e rrethanave kombëtare të tregut global dhe zhvillimet në sektorin financiar. Edukimi financiar dhe ndërgjegjësimi duhet të promovohen nga të gjitha palët dhe informacioni të jetë i qartë për mbrojtjen e konsumatorit. Të drejtat dhe përgjegjësitë duhet të jenë lehtësisht të arritshme nga ana e konsumatorëve. Në prezantim u theksua që, në kushtet aktuale duhet të zhvillohen mekanizma të përshtatshëm për të ndihmuar konsumatorët, në zhvillimin e njohurive, aftësitë dhe besimin e duhur për të kuptuar dhe përfshirë rreziqet financiare e mundësitë, të bëjnë zgjedhje të informuara, të dinë se ku të shkojnë për ndihmë dhe rrjedhimisht të marrin masa efektive për përmirësimin e situatave financiare të tyre.

Mbledhja e Komitetit Teknik solli në vëmendje të pjesëmarrësve një përmbledhje të problematikave të diskutuara në mbledhjen e fundit. Në vazhdim u prezantuan materialet e mëposhtme:

- o Draft udhëzues për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve. Promovimi i qeverisjes së mirë ka qenë në qendër të përpjekjeve për reforma në shumë vende në vitet e fundit, duke rezultuar në hulumtime të gjera dhe miratimin e shumë standardeve kombëtare. Në mbledhje u theksua se autoritetet mbikëqyrëse duhet të luajnë një rol kyç në promovimin, monitorimin, miratimin dhe zbatimin e standardeve të qeverisjes dhe praktikave të shëndosha në fondet private të pensioneve. Megjithatë, kriza e fundit ngriti shqetësimin në lidhje me zbatimin në praktikë të këtyre parimeve të qeverisjes së mirë nga ana e institucioneve

- financiare, duke përfshirë fondet private të pensioneëve. Duke pasur parasysh dobësitë e qeverisjes së këtyre fondeve, të dala nga kriza, u nënvizua se për një efikasitet më të madh të kontrollit mbikëqyrës ajo duhet të shoqërohet me masa të tjera si: përmirësimin në organizimin e brendshëm dhe strukturat, duke fituar kompetenca të reja dhe duke zbatuar një qasje të bazuar në risk për mbikëqyrjen;
- o Prezantim mbi ndikimin e kushteve aktuale financiare dhe ekonomike në mbikëqyrjen e pensioneëve;
  - o Mbikëqyrja e fondeve të tregtimit në Bursë;
  - o Pensionet dhe media sociale;
  - o Opsione të mashtrimit, auto regjistrimit e mbikëqyrja e tyre;
  - o Vetëvlerësimi dhe Parimet e IOPS-it në Angli nga përfaqësues të autoritetit anglez;
  - o Forcimi e mbikëqyrjes së pensioneëve të ndërmjetësve financiarë, paraqitur nga autoriteti homolog i Afrikës Jugut;
  - o Prezantimi mbi strukturën e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneëve në Australi;
  - o Projekteti DC (skemat me kontributet e përcaktuara) diskutuar nga akademikë Anglezë;
  - o Stress test i fondeve të pensioneëve DC.
- b) Seminari i IOPS/TPR për reformat dhe zhvillimet e Sistemit të Pensioneve Private në Angli**
- Ndër temat e trajtuara në seminar, përmendim:
- o *Reformat në sistemin e pensioneëve në sektorin e punësimit në Angli* ku fokusi ishte lidhur me procesin e auto regjistrimit dhe pajtueshmërinë me punëdhënësin;
  - o *Trustet e Kursimit të Punësimit Kombëtar (National Employment Savings Trust) (NEST) në të cilin u diskutuan struktura, detyrimet dhe investimet në NEST;*
  - o *Mbikëqyrjen me bazë risku dhe rolin e saj në rregullimin e skemave DC.*
  - o *Mbikëqyrjen financiare në Angli.* Këtu sesioni u fokusua në reformat për rregullimin financiar dhe sfidat në mbikëqyrjen financiare në Angli, ku u dhanë edhe eksperiencia të vlefshme të fushës.
- Interesimi i pjesëmarrësve në këto takime, përforcoi nevojën e organizmit më të shpeshtë të tyre si mundësi shkëmbimi të përvojave dhe njohjes së praktikave më të mira.

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Tregu i sigurimeve për muajin janar 2012

<http://amf.gov.al/pdf/publikime/SigurimeJanar2012.xls>

Buletini Statistikor për muajin janar 2012, përmban pasqyra të detajuara të ndarjes së Tregut të Sigurimeve,

sipas llojit të sigurimit, produkteve të sigurimit, pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit në treg, etj.

## EDUKIMI I KONSUMATORIT

### Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private dhe roli i tyre në edukimin financiar

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e OECD-së, nëntor 2011)

[http://www.oecd.org/document/8/0,3746,en\\_2649\\_15251491\\_41210376\\_1\\_1\\_1\\_1,00.html](http://www.oecd.org/document/8/0,3746,en_2649_15251491_41210376_1_1_1_1,00.html)

(Materiali informativ është përpiluar nga një pyetësor i gjerë për çështjet e komunikimit dhe edukimit financiar nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve private vullnetare. Në numrin e kaluar ju lexuat disa pika kryesore të këtij materiali informativ të hartuar nga bashkëpunimi i IOPS-it dhe OECD. Në vazhdimësi mund të lexoni disa tematika dhe shembuj nga vende të ndryshme).

#### Edukimi financiar dhe kriza

Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE), i krijuar nga OECD, në vitin 2008, krahas punës së përgjithshme për edukimin financiar, ka parë edhe pasojat e krizës mbi këtë edukim. INFE, vë në pah, se kriza ka qenë një çast nga i cili mund të mësohet përmes vërtetimeve të ndryshme në shumicën e vendeve, të cilat kanë treguar se konsumatorët tani kërkojnë më shumë informacion financiar dhe kanë dëshirë t'i kuptojnë më mirë rrjedhojat e çështjeve të ndryshme financiare në jetën e përditshme të tyre (megjithëse, studimet kanë treguar se edhe konsumatorët kanë prirjen të harrojnë shpejt dhe se, për të qenë efikase, mësimet duhen përsëritur në forma të tjera). Kjo punë kërkimore ka nxjerrë në pah se kriza ka vepruar edhe si shtytës për zhvillimin e një qasjeje më afatgjatë për rritjen e njohurive financiare, nga ana e atyre që vendosin për politikat).

Edhe pse i njeh kufizimet që ka edukimi financiar në parandalimin dhe zbutjen e krizave të ardhshme dhe të pasojave të tyre, INFE thekson, se rritja e zotësive financiare tek individët, mund të luajë

një rol pozitiv në kufizimin e zhvillimit dhe pasojave të krizave të mundshme në vazhdimësi, ku aftësia financiare individuale do të jetë bërë një komponent jetik i stabilitetit financiar kombëtar dhe botëror. Individët me zotësi dhe besim financiar i përfitojnë më mirë zhvillimet ekonomike dhe financiare, tregjet dhe rregulloret, si dhe do ta kuptonin më mirë bazën logjike të reformave të veçanta. Në kohët e vështirësive financiare, ata do të kishin më shumë gjasa të vepronin në mënyrë të logjikshme, duke shmangur sjelljet me panik dëmtues dhe zmadhimin e krizës, çka mund të jetë me shumë rëndësi në ato vende që kanë zbatuar ose do të zbatojnë një reformë në fushën e pensioneve, duke përfshirë këtu edhe kalimin e riskut dhe menaxhimit të investimeve tek individët. Në këtë kuadër, rritja e aftësisë financiare do t'i ndihmonte konsumatorët të vlerësonin rrjedhojën e natyrës afatgjatë të kursimit për pension dhe do t'u ofronte mundësinë për t'i investuar më mirë pasuritë e tyre. Nga ana e saj, kjo do të ofronte sigurinë që, në kohën e daljes në pension, familjet të marrin të ardhura, në përputhje me nevojat dhe pritshmërinë e tyre.

#### Kriza dhe fushatat e pensioneve

Në vitin 2009, OECD dhe IOPS botuan një material në të cilin shihej efekti që kishte kriza financiare dhe ekonomike tek sistemet e pensioneve dhe kundërpërgjigjet e mbikëqyrësve, duke përfshirë edhe fushatat e komunikimit për nënvijëzimin e natyrës afatgjatë të

Rritja e aftësisë financiare do t'i ndihmonte konsumatorët të vlerësonin rrjedhojën e natyrës afatgjatë të kursimit për pension dhe do t'u ofronte mundësinë për t'i investuar më mirë pasuritë e tyre.

kursimeve për pensionet.

Në materialin e IOPS-it vërehet, se kriza financiare dhe ekonomike e viteve të fundit e ka vënë në sprovë besimin tek institucionet financiare në përgjithësi. Edhe pse fondet e pensioneve nuk qenë as burimi e as mekanizmi i përhapjes së krizës, ato nuk i shpëtuan rënies së përgjithshme të besimit të shërbimit financiar. Për më tepër, ka të dhëna për një rënie të kontributeve në skemat vullnetare. Kjo thekson rëndësinë e ringritjes së besimit të sistemit të pensioneve, sidomos kur janë organizuar mbi baza vullnetare dhe nevojën për t'i zvogëluar dhe komunikuar më mirë risqet dhe zbulimin ndaj "rastit më të keq" për ata individë të cilët e financojnë pensionin e pleqërisë kryesisht nëpërmjet pasurive

të akumuluar në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara. Më tej materiali i IOPS-it vëren se roli i ringritjes së besimit të sistemit të pensioneve shpesh u bie autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve.

Në këtë kuadër, autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve në shumë vende i kanë rritur strategjitë e tyre të komunikimit rreth kohës së krizës financiare dhe paqëndrueshmërisë në tregjet financiare.

Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve në vendet e ndryshme kanë qëllime dhe objektiva të ndryshme, të cilat kanë dashur t'i arrijnë përmes fushatave të tyre, çka thekson rolet e ndryshme që luajnë këto autoritete mbikëqyrëse në ofrimin e edukimit financiar. Disa prej këtyre qëllimeve kryesore kanë qenë:

### **Nxitja e kursimeve afatgjata**

Një objektiv kyç i shumë prej fushatave të organizuara nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve, në përgjigje të krizës, ka qenë qetësimi i investitorëve dhe informimi i anëtarëve të fondeve të pensioneve, se këto investime janë afatgjata dhe se tregtimi reagues dhe këmbimi i aktiveve mund të ketë pasoja negative.

**Në Itali**, efekti negativ i krizës për fondet e pensioneve i kanë bërë familjet dhe investitorët të shqetësohen për reformën e kohëve të fundit në sistemin e pensioneve, ku është futur kërkesa për përfshirje automatike. Mbikëqyrësi i fondeve të pensioneve ka marrë disa masa në fushat e rregullimit dhe edukimit për ta zbutur pasojën e krizës dhe për të rivendosur besimin. Sa i takon ndërgjegjësimin dhe edukimin, këto masa kanë përfshirë një fushatë të gjerë në media, përhapje më pak të shpeshtë të informacionit për ecurinë e fondeve të pensioneve, informim më të mirë për çmuarjet e pensioneve dhe në plotësim të këtyre skemave drejt një strategjie financiare dhe edukative për pensionet në nivel kombëtar, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit.

**Në Maqedoni**, autoriteti mbikëqyrës (MAPAS) dha (përmes mediave publike) një shpjegim për situatën dhe pasojat tek anëtarët e fondeve të pensioneve, duke i informuar këta për pasojat aktuale të krizës dhe një shpjegim për perspektivën dhe natyrën afatgjatë të sistemit të pensioneve.

Programet e theksuara janë ato ku autoriteti i mbikëqyrjes së pensioneve punon drejtpërdrejt me anëtarët e fondeve të pensioneve.

## Riformimi i dhënies së informacionit

Krahas fillimit ose mbështetjes të fushatave për të theksuar natyrën afatgjatë të kursimeve për pension, disa autoritete i kanë nxitur ose u kanë kërkuar ofruesve të pensioneve t'u dërgojnë informacion shtesë anëtarëve të skemës. Ndërkohë, disa autoritete e kanë përdorur krizën për ta riformuar mënyrën me të cilën informacioni u komunikohet anëtarëve të skemës.

### Autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve dhe fushatat e tanishme të edukimit financiar

Në vitin 2007, IOPS botoi një material ku trajtohej roli i autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve në ofrimin e edukimit, punës afruese dhe komunikimit si mbikëqyrës, përfshirë edhe trajnimin e administratorëve të besuar. Në material shpjegohej mënyra dhe arsyeja e realizimit të programeve të tilla nga autoritetet mbikëqyrëse të pensioneve, duke analizuar efektin dhe efektivitetin e tyre, me shembuj nga Kenia, Irlanda, Afrika e Jugut dhe Mbretëria e Bashkuar.

Materiali arrin në përfundimin, se jo vetëm që ka një nevojë të madhe për edukim mbikëqyrës, por se ofrimi i këtij edukimi ndikon pozitivisht në sektorin ekonomik të pensioneve. Në studim argumentohej se ofrimi i edukimit mbikëqyrës, jo vetëm që ka çuar në rritjen e respektimit të akteve ligjore e nënligjore nga ana e skemave të pensioneve, por kjo ka sjellë edhe sa më poshtë:

- Njohuri më të mira, nga ana e palëve të interesit, lidhur me atë që pritet prej tyre;
- Marrëdhënie të përmirësuara ndërmjet mbikëqyrësve dhe palëve të interesit;
- Skema të administruara më mirë;
- Kthime më të mira për anëtarët;
- Besim i rritur mes anëtarëve, si dhe;

- Rritje e kursimeve për pensione, të gjitha grupeve të individëve.

Gjithashtu është parë se ofrimi i edukimit mbikëqyrës mund të përdoret për të trajtuar sfidat e respektimit të kërkesave ligjore dhe të mbulimit e për rrjedhojë është një mënyrë efektive e promovimit të zhvillimit të sektorit ekonomik të pensioneve.

Disa nga mbikëqyrësit vlerësojnë edhe efektivitetin e kanaleve të ndryshme që përdoren për dhënien e informacionit. Mënyrat që preferojnë shumica e agjencive për të matur reagimin janë mendimet që kanë dhënë grupet e synuara dhe vlerësimi i reagimit të tregut ndaj informacioneve të dhëna.

Përmes përditësimit punës së mëparshme të IOPS-it, pjesa e mëposhtme jep një informacion të përgjithshëm për programet e edukimit të mbuluar nga disa autoritete mbikëqyrëse të pensioneve të përzgjedhura. Krahas fushatave të izoluar, të cilat përshkruhen në pjesën më lartë e të cilat janë zhvilluar në përgjigje të krizës financiare dhe ekonomike, shumë autoritete mbikëqyrëse të pensioneve kanë zhvilluar edhe programe të vazhdueshme të dhënies së informacionit dhe edukimit për anëtarët e fondeve të pensioneve. Programet e theksuara janë ato ku autoriteti i mbikëqyrjes së pensioneve punon drejtpërdrejt me anëtarët e fondeve të pensioneve (pra nuk jep informacione të natyrës së përgjithshme publikut të gjerë).



## Turqia

Shembulli i autoritetit të mbikëqyrjes së pensioneëve në Turqi është interesant, sepse tregon se si mund të përdoret kontakti i drejtpërdrejtë me anëtarët e fondeve përmes vrojtimeve, në mënyrë që të ngrihen, orientohen dhe përmirësohen programet e edukimit financiar.

Qendra e Monitorimit të Pensioneëve (QMP) ofron një gamë programesh të edukimit financiar (duke përfshirë edhe fushatat e gjera në media). Kjo qendër punon edhe me partnerët e sektorit privat, (përmes Komitetit të Komunikimit) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, nxitjen e njerëzve që të mendojnë për pensionin e pleqërisë dhe theksimin e rëndësisë që ka planifikimi afatgjatë për pensionin.

Qendra e Monitorimit të Pensioneëve punon me Thesarin e Turqisë për të siguruar të dhëna dhe për të ndihmuar në kontrollin mbikëqyrës të pensioneëve.

Sa i takon edukimit që u ofrohet anëtarëve të skemave të pensioneëve, si edhe dhënies së informacionit dhe ofrimit të aplikacioneve llogaritëse në hapësirën e saj në Internet, Qendra e Monitorimit të Pensioneëve bën edhe vrojtime (përmes telefonit) me këto qëllime:

- Vlerësimi i njohurive të pjesëmarrësve për sistemin e pensioneëve (duke përfshirë edhe arsytet për tërheqjen përpara kohe nga skema, njohuritë dhe shkallën e shfrytëzimit për lehtësirat tatimore, etj.);
- Vlerësimi i cilësisë dhe sasisë së informacioneve që u japin pjesëmarrësve shoqëritë e pensioneëve;

- Informimi i pjesëmarrësve;
- Analizimi dhe raportimi i rezultateve pranë Nën/sekretariatit të Thesarit (që është autoriteti kryesor mbikëqyrës në Turqi) për nevojat dhe boshllëqet në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese.

Telefonatat dalëse të Qendrës mund të klasifikohen në tre kategori: telefonata inspektimi, telefonata udhëzuese për një çështje të përgjithshme ose të veçantë dhe telefonata që mbledhin informacion për mendimet/modelet e sjelljes të pjesëmarrësve. Zakonisht, në varësi të qëllimit të vrotimit, përdoret një ndërthurje e të tri kategorive.

Temat e vrojtimeve përmes telefonit i përcakton QMP në bashkërendim me Nën/sekretariatit të Thesarit, duke marrë në konsideratë rëndësinë relative dhe pasojat e mundshme që mund të ketë çështja në fjalë tek zhvillimi i tregut dhe besimi që ka publiku te sistemi në tërësi. Ankesat dhe kërkesat për informacion që depozitohen pranë qendrës, analiza e tendencës, e kryer në bazë të të dhënave që dorëzojnë shoqëritë e pensioneëve, shtypi, konjunkturat ekonomike dhe sociale, të gjitha ndikojnë në përzgjedhjen e problemit për të cilin do të bëhet vrotimi. Merren në konsideratë mendimet e përfaqësuesve të sektorit privat për të dëgjuar pikëpamje të ndryshme, si edhe për të shfrytëzuar njohuritë e tyre prej eksperti.

Pasi vendoset tema, periudha dhe shpeshësia e vrotimit, QMP përcakton grupin e synuar duke përdorur të dhënat që dorëzojnë shoqëritë e pensioneëve. Për secilin vrotim, pyetësorin e harton QMP duke e dorëzuar më pas për miratim tek Nën/sekretariati i Thesarit. Pyetësori merr formën e tij përfundimtare pas telefonatave testuese.

*Vijon në numrin tjetër...*

QMP përcakton grupin e synuar duke përdorur të dhënat që dorëzojnë shoqëritë e pensioneëve. Për secilin vrotim, pyetësorin e harton QMP duke e dorëzuar më pas për miratim tek Nën/sekretariati i Thesarit. Pyetësori merr formën e tij përfundimtare pas telefonatave testuese.

## ZHVILLIME TË TJERA

### **Bazel: Të rejat e fundit në veprimtarinë e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve, si dhe projektet në vazhdim të saj**

Më 23 shkurt 2012 në Bazel, Zvicër, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit të Koordinimit të Pensioneve, të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS). Në mbledhje u diskutua mbi të rejat e fundit në veprimtarinë e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), si dhe projektet në vazhdim të saj, duke përmendur:

- Projektin “Mbi hartimin e udhëzimeve për qeverisjen më të mirë të autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve” - qëllimi i hartimit të këtyre udhëzimeve është pajisja me një listë kriteresh të miratuara ndërkombëtare, të cilat duhen të merren parasysh për një qeverisje sa më të mirë, si dhe hartimi i një liste veprimesh, të cilat lejojnë vlerësimin e efektivitetit të strukturave dhe praktikave qeverisëse të autoriteteve mbikëqyrëse.
- Projektin “Mbi *Stress Tests* për fondet e pensionit me kontribute të përcaktuara” - qëllimi i këtij projekti është studimi dhe krahasimi i vlerësimit të modeleve dhe mekanizmave aktuale të *Stress Testing* për fondet e pensionit me kontribute të përcaktuara të përdorura nga vendet anëtare të IOPS-it.
- Projektin “Mbi strukturimin dhe organizimin e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve” - qëllimi i këtij projekti është trajtimi i çështjeve problematike që kanë të bëjnë me strukturimin e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve për

ushtrimin e funksioneve në mënyrë sa më efektive, duke e parë edhe në këndvështrimin e krizës globale financiare.

Përditësimi i situatës aktuale në fushën e pensioneve nga Banka Botërore dhe Bashkimi Evropian, u diskutuan në vazhdim. Ekspertë të BE-së, u fokusuan në rishikimin që do t'i bëhej Direktivës 2003/41/EC për fondet e pensioneve profesionale dhe në krizën aktuale financiare që po kalojnë vendet anëtare të BE-së, si dhe efektet negative që mund të ketë kjo krizë në tregun e pensioneve të Komunitetit Evropian. Ndër problemet më kryesore që u theksuan nga përfaqësuesit e BE-së ishin: mungesa e rregullimit të pensioneve me kontribute të përcaktuara, nevoja për zgjerimin e objektivit të Direktivës 2003/41/EC, mungesa e rregullave të përshtatshme për aftësinë paguese të fondeve të pensioneve, nevoja për kërkesa më të mira për përshtatshmëri dhe aftësi, qartësimi i disa përkufizimeve të Direktivës, qartësimi i produkteve, të cilat ofrohen nga fondet e pensioneve, etj.

Mbledhja e Grupit të Koordinimit të Pensioneve vazhdoi me rishikimin e Marrëveshjes së Koordinimit ndërmjet IAIS-it dhe IOPS-it, ku u ra dakord nga Komiteti për ndryshimin e disa dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Nga përfaqësuesit e IAIS-it u sugjerua hartimi i një tablele për krahasimin dhe rishikimin e parimeve të IOPS-it me ato të IAIS-it, çështje e cila u la për diskutim edhe në takimet e tjera të ardhshme.

Ekspertë të BE-së, u fokusuan në rishikimin që do t'i bëhej Direktivës 2003/41/EC për fondet e pensioneve profesionale dhe në krizën aktuale financiare që po kalojnë vendet anëtare të BE-së, si dhe efektet negative që mund të ketë kjo krizë në tregun e pensioneve të Komunitetit Evropian.

## Qipro: Produktet e reja financiare: Sfidat e tyre rregullatore dhe përgjegjësia e IOSCO-s

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në bashkëpunim me Sekretarinë e Përgjithshme të IOSCO-s dhe Komisionin e Letrave me Vlerë të Qipros zhvilluan gjatë periudhës 22 deri më 24 shkurt 2012 seminarin me temë “Produktet e reja financiare: Sfidat e tyre rregullatore dhe përgjegjësia e IOSCO-s”.

Seminari ishte i hapur për të gjithë anëtarët e IOSCO-s në funksion të përmirësimit të rregullimit ligjor në fushën e letrave me vlerë brenda vendeve anëtare. Programi i seminarit u hartua duke u bazuar në përgjigjet e ardhura nga vendet anëtare të IOSCO-s duke analizuar nevojat e trajnimit të gjithsecilit.

Qëllimi i seminarit ishte ofrimi i udhëzimeve praktike lidhur me rregullimin ligjor të produkteve të reja financiare. Kriza e tregjeve të kredidhënies në vitet 2008 dhe 2009, theksoi rëndësinë

e rregullatorëve për të kuptuar këto instrumenta kompleksë financiarë, në mënyrë që të përmbushin sa më mirë përgjegjësitë e tyre rregullatore.

Rritja e instrumentave kompleksë derivativë, veçanërisht derivativët e kredisë, mund të kontribuojnë në sfidat rregullatore aktuale. Këto instrumente kanë potencialin për të përfaqësuar rreziqe ligjore dhe sfida për rregullatorët.

Në seminar u trajtuan tema si: çfarë e shkaktoi krizën financiare dhe përgjigja e rregullatorëve ndaj krizës, struktura mbikëqyrëse e rregullatorëve, tipi i riskut dhe mënyra e administrimit të tij, detyrimet ligjore me të cilat përballen shërbimet financiare, etj.

Mjaft diskutime u përqendruan në produktet e reja financiare, zhvillimin e tyre dhe si mund të vlerësohen ato nga rregullatorët.

Kriza e tregjeve të kredidhënies në vitet 2008 dhe 2009, theksoi rëndësinë e rregullatorëve për të kuptuar këto instrumenta kompleksë financiarë, në mënyrë që të përmbushin sa më mirë përgjegjësitë e tyre rregullatore.

## TË REJA NGA RAJONI

### Mali i Zi: MTPL ende dominon, por konkurrenca rritet në sigurimin e jetës

<http://www.xprimm.com/>

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Agjencia e Sigurimit të Mbikëqyrjes të Malit të Zi, primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në vitin 2011 arritën në 65,3 milionë Euro, me një rritje prej 5.4% krahasuar me vitin 2010, vit në të cilin primet e shkruara bruto ishin në 62 milionë Euro. Ndërkohë që primi bruto për frymë në vitin 2011 arriti në rreth 99 Euro.

Tregu i sigurimeve në Malin e Zi, vazhdoi të karakterizohej nga një

nivel i ulët në sigurimin e jetës duke dominuar pjesa e sigurimeve të jo-jetës. Pjesa më e madhe i përkiste sigurimit të detyrueshëm TPL (46% të tregut total). Në strukturën e primit bruto, në vitin 2011, përqindja e sigurimeve të jo-jetës arriti në 86%, ndërsa pjesa e sigurimit të jetës është rritur në 14%. Rritje më të madhe kanë patur primet e sigurimeve të jetës me 8.6% ndërsa sigurimet e jo-jetës janë rritur me 4.9%.

Tregu i sigurimeve në Malin e Zi, vazhdoi të karakterizohej nga një nivel i ulët në sigurimin e jetës duke dominuar pjesa e sigurimeve të jo-jetës.

Dinamika e lartë në segmentin e sigurimit të jetës është vërejtur në të dy rajonet (tregu serb dhe boshnjak) ndërsa zhvillimi më i rëndësishëm (+15,4%) është regjistruar në tregun shumë të vogël të sigurimeve të jetës në Republikën Serbe.

## **Bosnje Hercegovinë: Sigurimi i jetës fiton përqindje të reja**

<http://www.xprimm.com>

Tregu boshnjak i sigurimeve e përfundoi 2011 me një normë rritje pozitive prej 3.4% në primet e shkruara bruto krahasuar me 2010. Primet e shkruara bruto arritën 249.5 million Euro.

Deri në fund të vitit 2011, sigurimi i jetës arriti një peshë specifike rreth 16.4% në portofolin e tregut të Bosnjës, për shkak të një normë rritjeje mbi mesatare, prej 7.4%. Dinamika e lartë në segmentin e sigurimit të jetës është vërejtur në të dy rajonet (tregu serb dhe boshnjak) ndërsa zhvillimi më i rëndësishëm (+15,4%) është regjistruar në tregun shumë të vogël të sigurimeve të jetës në Republikën Serbe të Bosnjës.

Sigurimi i jo-jetës në tregun boshnjak

u rrit me 2.65% në vitin 2011 krahasuar me 2010 duke kapur një vlerë 208.6 milion Euro. Kompanitë në Republikën Serbe të Bosnjës gjithashtu rritën peshën e tyre me 1 pikë përqindje në këtë segment. Sigurimi shëndetësor pati performancën më të keqe, duke zbritur me 22.5%. Në përmasa të ndryshme, këto tendenca ishin të zakonshme për të dy rajonet.

Linja e sigurimit motorik regjistroi një zhvillim pozitiv, padyshim duke qenë MTPL kryesuese në të dy rajonet. Shkalla e përgjithshme e rritjes së këtij segmenti ishte 2.56 %, deri në 151.6 milion Euro të vëllimit në primeve të shkruara bruto.

## **Hungari: Tregu i sigurimeve ende i trazuar**

<http://www.xprimm.com>

Sipas shoqatës hungareze të siguruesve, MABIS, në 2011, të ardhurat nga primet e sigurimeve të kombinuara, si pasojë e indeksimit të inflacionit, patën një rënie prej 2.7% ose 821 bilion Forinta hungareze (HUF). Në terma nominalë, tregu pati një rritje prej 0.38%. Të shprehura në monedhën evropiane, shifrat në 2011 tregojnë një pamje edhe më shqetësuese, me një rënie 10% në primet e shkruara bruto ose 2,64 bilion Euro, pas zhvleftësimit me pothuajse 12% në terma vjetorë të kursit të këmbimit të monedhës hungareze. Gjithsej numri i policave ra me 60.000 kontrata.

Segmenti i sigurimit të jetës u rrit me 5.5%

krahasuar me 2010. Ndryshimi nominal është 439.8 miliard HUF ose 1.4 bilion Euro. Sigurimet e lidhura me fondin e investimit aktualisht përfaqësojnë mbi 66% të portofolit të sigurimit të jetës dhe janë klasa e vetme duke shënuar një ndryshim pozitiv, prej 10.6%, ndërsa në klasat tradicionale të sigurimit të jetës ka patur një rënie prej rreth 4.5%.

Në sigurimin e jo-jetës shifrat e 2011 tregojnë një rënie në primin e shkruar bruto, prej gati 5% (nominale, HUF) ose 381 bilion HUF (1.22 bilion Euro). Policat e sigurimit nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore gjeneruan 89.7 bilion HUF, ose e 4.15% më shumë se një vit më parë në terma nominalë.

### **Për këtë numër punuan:**

*R. Guri, D. Kalaja, V. Theodhori, E. Sherri, Dh. Hazbiu,  
R. Eltari, E. Kokona*